



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2626, datë 29.10.2015

Për

Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr.20 datë 19.02.2010 “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1.	Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2.	Z. Alban	Karapici	Anëtar
3.	Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4.	Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5.	Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku në mbledhjen e datës 29.10.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr.20 datë 19.02.2010 “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar.

B A Z A L I G J O R E :

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
2. Neni 24, pikat 1 dhe 2 të nenit 117, pika 1 gërma a) e nenit 119 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918), neni 27 Ligji nr.46/2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”;
3. Rregullore Nr.20 date 19.02.2010 “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1170 datë 19.02.2010, ndryshuar me VKD nr. 2521, datë 06.11.2014;
4. Urdhër nr.1526 date 9.09.2015 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumentit për ndërhyrje legjislativ në aktin normativ administrativ "Rregullore nr. 20, datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar;
5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim publik Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr. 20, datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar,
2. Dokumenti për këshillim publik Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr. 20, datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar,
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Dokumenti për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në dokumentin Rregullore nr. 20, datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.

2. Hartimi i dokumentit është bazuar në Nenin 24, pikat 1 dhe 2 të nenit 117, pika 1 gërma a) e nenit 119 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 27 Ligji nr.46/2015 datë 7.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".

3. Qëllimi i hartimit të shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 20 datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike" të ndryshuar, është reflektimi dhe pasqyrimi i ndryshimeve të ndodhura me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.46 datë 07.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje dhe pagesat e tjera që kryhen sipas neneve 78 dhe 86 të ligjit nr. 9918/2008, si dhe pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar sipas nenit 27 të ligjit 46/2015, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, në përputhje me nenin 117 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe neni 27 të ligjit 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në sa më sipër dhe në kompetencat që i janë dhënë nga:

-Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, "Kodi i procedurave administrative" i ndryshuar;

-Neni 24, pikat 1 dhe 2 të nenit 117, pika 1 gërma a) e nenit 119 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918), neni 27 Ligji nr.46/2015 datë 7.05.2015 "Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë".

V E N D O S :

1. Miratimin e dokumentit për Këshillim Publik "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr. 20 datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike" të ndryshuar, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Periudha e Këshillimit Publik do të jetë 30 ditë nga dita e publikimit zyrtar të këtij dokumenti në faqen e internetit të AKEP www.akep.al

3. Ky Vendim dhe dokumenti Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr. 20 datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike" të ndryshuar, të publikohet në faqen elektronike të AKEP www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

P i r o X H I X H O

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____